


AKTIVITETE TË ORGANIZUARA NGA KLINIKA LIGJORE “WISDOM”

- Klinika Ligjore dhe Njësia e Kërkimit Shkencore dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Fakultetin e Drejtësisë në KUW në kuader të implementimit të marrëveshjes me studion Ligjore “Drilona Bara” realizuan sot në datë 12 Dhjetor 2019 trajnimin me eksperten Znj. Drilona Bara, e cila trajnoi studentët e programeve profesionale dy vjeçare “Asistent Juridik”. Trajnimi ishte në formë improvizimi rolesh mes avokatë, klient dhe gjykates gjithashtu u diskutuan edhe çështje të tjera sesi studentët duhet të hartojnë dhe përpilojnë një kërkese-padi, memo etj. Ky trajnim nxiti shumë diskutime dhe realizoi me efikasitet punën në grupe mes studentëve dhe trajnueses. Në fund studentet u pajisën me certifikata.



- Qendra "Klinika Ligjore Wisdom" dhe Fakulteti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar Wisdom në datën 16 Maj 2020 ora 11:00 organizuan Leksionin e hapur Online me temë "COVID-19 dhe ndikimi në sistemin gjyqësor Britanik" I ftuar, Gazetari i mirënjohur dhe Juristi në Britaninë e Madhe Z. Kujtim Vani, Ish-Studenti i Fakultetit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar "Wisdom". Ky leksion u transmetua live në televizionin FAX NEWS.



- Ditën e sotme datë 18 Dhjetor 2019, Dekani i Fakultetit të Drejtësisë, Prof. Asc. Dr. Naim Mëçalla dhe Drejtori i Qendrës "Klinika Ligjore Wisdom" Av. Alban Duraj kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Zyrën Noteriale "Genci Duraj" dhe Zyrën Përmbartimore Private "Bailiff Services Albania". Tashmë studentët e Programit të Drejtësisë dhe të Asistentit Juridik të Kolegjit Universitar Wisdom do të kenë mundësi të marrin përvojë profesionale në këto zyra.



- Kolegji Universitar “ Wisdom” në bashkëpunim me Qendrën “Klinika Ligjore Wisdom” në 20 Maj 2020 organizoi leksion online me temë: “ KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË, ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE SFIDAT”. Ishte kënaqësi të kishim të ftuar në këtë leksion Zv. Kryetar i Këshillit Lartë të Prokurorisë Z. Alfred Balla.




LEKSION ONLINE
TEMA
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË, ORGANIZIMI, FUNKSIONIMI DHE SFIDAT
DITEN E MERKURË, DATE 20 MAJ, ORA 10:00
I Ftuar Zv. Kryetari i Këshillit Lartë të Prokurorisë Z. Alfred Balla

- Sot në 29 Janar 2020, Njësitë e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë të Kolegjit Universitar Wisdom në bashkëpunim me Qendrën "Klinika Ligjore Wisdom" realizuan trajnimin me temë: "Huamarrje e Zgjuar dhe Kontratat me Institucionet e Microcreditit". E ftuar ishte Znj. Vjollca Muçaj PHDc, Drejtoreshë e Departamentit të Riskut në Institutin Financiar "Agro&Social Fund". Studentët pedagogët dhe pjesëmarrësit mësuuan shumë nga ky trajnim pasi Drejtoreshë Vjollca Muçaj shpjegoi qartë dhe me detaje llojet e kredive, normat e interesit, penaltitet, të drejtat dhe detyrimet e palëve. Kolegji Universitar "Wisdom", Agro&Social Fund dhe Qendra "Klinika Ligjore Wisdom" nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi e cila parashikon që: studentët e Kolegjit Universitar "Wisdom" të përfshihen në praktika mësimore, në mini projekte kërkimore, dhe mundësi punësimi për ta. Gjithashtu Agro&Social Fund do të ofrojë mundësi kreditimi me interesa të ulëta për studentët të cilët do të ndjekin studimet dhe studentët e diplomuar në Kolegjin Universitar "Wisdom" të cilët kanë projekt biznesi do të mbështeten financiarisht me norma të ulëta interesi. Në fund të trajnimit të gjithë studentët u pajisën me çertifikata.



- Qendra “KlinikaLigjore Wisdom” dhe Fakulteti i Drejtësisë në Kolegjin Universitar “Wisdom” organizuan në 10 maj 2020, Konferencën Kombëtare: "10 Maj Dita Kombetare e Drejtësisë dhe Ofrimi i Shërbimeve Ligjore Në Kohë Pandemie". Falenderojmë shumë Ministren e Drejtësisë Znj. Etilda Gjonaj për pjesmarrjen në këtë konferencë dhe për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë Klinikës Ligjore.



- Fakulteti i Drejtësisë dhe Qendra Klinike Ligjore "Wisdom" falenderon shumë Z. Kreshnik Tërnova Av, MPH, LL.M, Drejtor Rajonal i Shërbimeve të Transportit Rrugor Durrës për leksionin online të zhvilluar sot në datë 22 maj 2020 me temë: "Drejtorja e shërbimeve të transportit rrugor dhe problematikat në kohë pandemie". Leksioni ishte shumë i dobishëm, informues ku Z. Tërnova iu pergjigje të gjitha pyetjeve dhe shqetesimeve të studenteve e pedagogëve të Kolegjit Universitar "Wisdom" lidhur me problematikat që janë shkaktuar nga pandemia në transportin rrugor.



- Marreveshje Bashkepunimi me Dhomen Kombetare te Ndermjetesimit



- Sot në datën 12.10.2019 ora 10:00 në kuader të programit të veprimtarive kryesore të Departamentit të së Drejtës Publike, për Vitin Akademik 2019 – 2020, në bashkëpunimin me Zyrën e Kërkimit Shkencorë dhe Marrëdhëniet me Jashtë si dhe me Qendrën “Klinika Ligjore Wisdom” u realizua trajnimi profesional “Te njihemi me Profesionet e Lira”. I ftuar ishte Z. Altin Lartifi i cili:
 - Nga viti 2010 ushtron profesionin e Përmbauesit Gjyqësor Privat
 - Eshtë bashkëthemelues dhe drejtues i Shoqërisë “Enforcement Group” SHPK e cila është një nga shoqëritë e përmbaimit gjyqësor privat më të suksesshme në vendin tonë, ku: korrektesia, profesionalizmi, shpjgetesia, ndershmeria dhe efikasiteti janë parimet e kësaj shoqërie.
 - Duke filluar nga viti 2019 Altini është anëtar i këshillit Drejtues së Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privat.




NJOFTIM
(Për studentët e programit të studimit me karakter profesional "Asistent juridik")

Në kuadër të programit të veprimtarive kryesore të Departamentit të së Drejtës Publike, për VA 2019-2020, në bashkëpunimin me Zyrën e Kërkimit Shkencorë dhe Marrëdhëniet me Jashtë si dhe me Qendrën Klinika e Ligjit Wisdom, në ambjentet e KU Wisdom do realizohet trajnimi profesional me temë:
"Te njihemi me Profesionet e Lira".

DATE: 10 - 11. Dhjetor 2019
 Ora 10:00, Salla 8 , Godina B



Rruga "Medar Shylla", (Komuna e Parisit), Tiranë.
www.wisdom.edu.al
 tel: 042200063,
 cel: 067602273



- Në 13 Shkurt 2020 në Kolegjin Universitar "Wisdom" u zhvillua Konferenca Kombëtare me temë: "Thyej Tabune: Qarku Vicioz i Çështjeve të Shëndetit Mendor dhe Dhuna Familiare në Shqipëri" e organizuar nga Shoqata "Në Dobi të Gruas Shqiptare" & The Ballkanista/Alice Taylor në bashkëpunim me Kolegjin Universitar "Wisdom", Qendra "Këshillimore për Njerëz me Aftësi të Kufizuar", Qendra "Klinika Ligjore Wisdom" dhe Klinika Psikologjike "Urtesia".

Në këtë aktivitet morën pjesë: gra-viktima të dhunës, aktivistë, studentë, nxënës, ekspertë nga fusha e psikologjisë, psikiatrisë, gazetarë, pedagog dhe avokatë.

Në këtë konferencë u diskutua rreth fenomenit të dhunës ndaj grave, formave të saj, u dhanë zgjidhje se si mund të luftohet ajo dhe të minimizohet në maksimum nga të gjithë aktorët e shoqërisë Shqiptare me ne krye shtetin dhe strukturat e tij ligjzbatuese.

Dekani i Fakultetit të Drejtësisë në Kolegjin Universitar "Wisdom" Prof. Asc. Dr. Naim Mecalla u shpreh se: "Për më shumë se një dekadë Kolegji vazhdon të nxjerrë breza dhe gjenerata të diplomuarish me sukses në fushën e drejtësisë, psikologjisë dhe ekonomisë. Misioni i Kolegjit Universitar "Wisdom" është të japë kontributin e tij për të diplomuar studentë të cilët të jenë qytetarë të denjë dhe profesionistë. Në këtë kontekst Kolegji është aktiv duke dhënë ndihmën e tij kundër fenomeneve që e shqetësojnë shoqërinë shqiptare siç është edhe dhuna ndaj grave. Pedagoget dhe studentet e KU "WISDOM" nëpërmjet Qendrës "Klinika Ligjore Wisdom" dhe Klinikës Psikologjike "Urtesia" ofron ndihmë psikologjike dhe juridike FALAS për gratë e dhunuara në mënyrë që t'ja lehtësoj sa më shumë dhimbjen".

